



ZGJIDH
TË VENDIT

KATALOGU I PRODHUESVE VENDAS

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), me qëllim fuqizimin dhe rritjen e aftësive konkurruese të bizneseve vendase, ndërmerr të gjitha nismat e nevojshme duke hartuar, zhvilluar dhe koordinuar programe ose projekte për zhvillimin dhe rritjen e tyre.

Misioni i AIDA-s është të forcojë kapacitetet e biznesit shqiptar për të konkurruar jashtë vendit si dhe, të luajë një rol të rëndësishëm për ndërtimin e një imazhi të denjë për Shqipërinë me fokus fuqizimin e bizneseve vendase, rritjen e mundësive të kompanive për eksport dhe tërheqjen e investitorëve të ndryshëm.

Në bazë të interesit të lartë të shprehur nga vetë kompanitë, por edhe biznese të kontaktuar nga stafi i AIDA-s, është bërë identifikim i disa prej produkteve vendase për fushatën katalogun “Zgjidh të Vendit” dhe përshkrimi i tyre.

Në fokus kryesor të çdo përshkrimi, janë produktet e prodhimit vendas, një historik i shkurtër i kompanisë, si edhe të dhëna të domosdoshme kontakti.

Qëllimi ynë është të njohim, zgjedhim dhe duam çdo ditë produktet shqiptare. T'i japim jetë artizanatit, produkteve autentike dhe unike duke bërë bashkë çdo copëz që formon historinë e Shqipërisë me vlera.

SEKTORİ IVERƏS





Emri i kompanisë: BELBA

Data e themelimit: 28.06.2011

Nipti i kompanisë: L13028804I

Adresa e kompanisë: Kavajë, Rruga Egnatia

Personi i kontaktit: Fatbardh Belba

Tel/ Cel: +355684011136

E-mail: fatbardhbelba@hotmail.com

Web: www.belbawines.al

Nr. i punonjësve: 5

Përshkrim i shkurtër i kompanisë (Historiku)

Kantina Belba është një histori pasioni për Verën që ndërthur në mënyrën më perfekte traditën dhe praktikën italiane me klimën dhe variacionet e rrushit shqiptar. Elementi përbashkues është këmbëngulja për të krijuar një brand ndërkombëtar që si vullë ka cilësinë dhe shijen. Vëllezërit Belba që në moshë të re kanë emigruar në Itali ku kanë punuar dhe janë specializuar në kultivimin e vreshtave dhe përpunimit të rrushit, pikërisht në Montepulciano në zonën e Toskanës, një nga zonat më me emër në të bërit verë. Kjo eksperiencë është një gur themeli i suksesit të kantinës Belba.

Me vreshtat në zemër të Shqipërisë, në fshatin kodrinor të Golemit dhe aparaturat bashkëkohore në përpunimin e rrushit, në synojmë të sjellim në treg një verë të veçantë, që përbashkon mikro-elementët mineral të tokës, rrezeve të diellit, dashurine për vreshtarine dhe verberjen, dhe dëshirës për të servitur një verë të klasit të lartë.

E fokusuar kryesisht tek varietetet tipike të zonës si "Sheshi i Zi" dhe "Sheshi i Bardhë" kantina Belba nxjerr në treg verë 100% shqiptare.

Shtetet ku eksporton



Shtetet e
Bashkuara të
Amerikës



Belgjikë

Lista e produkteve që prodhojnë

Nr.	Produkti	Kapaciteti i prodhimit
1.	Melot (0.75l qelqi)	5000 shishe/ vit
2.	Papaz (0.75l qelqi)	5000 shishe/ vit
3.	Shesh I zi (0.75l qelqi)	7000 shishe/ vit
4.	Rezerve (0.75l qelqi)	7000 shishe/ vit

Nr.	Produkti	Kapaciteti i prodhimit
5.	E Kuqe (0.75l qelqi)	9000 shishe/ vit
6.	Chardonnay (0.75l qelqi)	3000 shishe/ vit
7.	Shesh I Bardhe (0.75l qelqi)	7000 shishe/ vit
8.	E Bardhe (0.75l qelqi)	9000 shishe/ vit



Emri i kompanisë: Petrit Çobo

Data e themelimit: 1998

Nipti i kompanisë: K32507027W

Adresa e kompanisë: Fshati Pashalli, Dimal, Berat

Personi i kontaktit: Petrit Çobo

Tel/ Cel: +355674063115

E-mail: kantina_cobo@yahoo.com

Web: www.cobowine.com

Nr. i punonjësve: 13

Përshkrim i shkurtër i kompanisë (Historiku)

Familja Çobo ka rreth një shekull që ruan më të mirat e tokës dhe të vreshtave. Nëpër trojet dhe fshehtësinë e Beratit, Çobo ruan shpirtin 2400-vjeçar të këtij qyteti të distiluar në shishe njëra mbi tjetrën.

Pas viteve '90, vreshtat e Çobos u ngrohën sërish nga dielli në frymën e kultivimit të varieteteve më të mira të rrushit, duke i qëndruar besnike traditës. Nga 8,000 shishe në 100,000, dashuria për verën është shumë më e madhe se të gjitha kokrrat e rrushit në të gjithë vreshtin.

Përgjatë rrugës në qarkun e Beratit, një qytet i vjetër në jug të Shqipërisë, kantina e verës ÇOBO sjell një traditë të përjetshme familjare kudo që jeni! Të kesh verën tënde të preferuar me vete kudo nuk ka qenë kurrë kaq e lehtë.

Shtetet ku eksporton



Zvicër



Itali



Belgjikë



Gjermani

Lista e produkteve që prodhojnë

Nr.	Produkti	Kapaciteti i prodhimit
1.	Shesh i Bardhe (0.75l)	10.000
2.	Puls e Bardha e Beratit (0.75l)	15.000
3.	Shesh i zi (0.75l)	12.000
4.	Kashmer (0.75l)	20.000

Nr.	Produkti	Kapaciteti i prodhimit
5.	Vlosh (0.75l)	15.000
6.	Kallmet Rozin (0.75l)	3000
7.	Raki (0.5l)	4000
8.	Shendeverë (0.75l)	10.000

Llojet e certifikimeve që zotërojnë





Emri i kompanisë: KALLMETI SH.P.K

Data e themelimit: 03.11.2006

Nipti i kompanisë: K77825502T

Adresa e kompanisë: Fshati Kallmet, Lezhë

Personi i kontaktit: Gjoke Gjini

Tel/ Cel: +355682035892

E-mail: gjoke.gjini@kantinakallmeti.com

Web: www.kantinakallmeti.com

Nr. i punonjësve: 10

Përshkrim i shkurtër i kompanisë (Historiku)

“Kallmeti” Sh.p.k është krijuar në vitin 2006. Aktivitetet kryesore janë prodhimi dhe tregtimi i produkteve: Vere, Raki dhe Vaj ulliri duke grumbulluar dhe përpunuar si lende të pare rrushin Kallmet të zones së Kallmetit dhe fshatrave përreth si dhe ullinjtë e Kallmetit.

Që nga viti i parë i aktivitetit, kapaciteti prodhues është rritur mesatarisht 20 % çdo vit deri në vitin 2019, pastaj është stabilizuar në shifra pa ndonjë rritje të konsiderueshme. Çilesia e produkteve ka ardhur duke u përmirësuar vit pas viti dhe tashmë janë bërë të njohura dhe të besueshme nga konsumatorët në tregun vendas dhe të huaj.

Vererat e Kantines Kallmeti janë vlerësuar me cmime dhe medalje të ndryshme në disa konkurse kombëtare, si dhe ndërkombëtare ku mund të përmendim: Decanter, London Wine Competition, Berliner Wine Trophy, Wine System International, Balcan Wine Competition, etj.

Shtetet ku eksporton



Zvicër



Belgjikë



Hollandë

Lista e produkteve që prodhojnë

Nr.	Produkti	Kapaciteti i prodhimit
1.	Verë Kallmet	80.000 - 100.000 litra/ vit
2.	Raki Rrushi Kallmet	4000 - 5000 litra/ vit
3.	Vaj Ulliri Kallmet	4000 - 5000 litra/ vit

Llojet e çertifikimeve që zotërojnë





Emri i kompanisë: Kantina Alimani

Data e themelimit: 2016

Nipti i kompanisë: L62002002B

Adresa e kompanisë: Rr.Tomi Kristo, Tiranë

Personi i kontaktit: Erjon Alimani

Tel/ Cel: +355694314445

E-mail: kantina.alimani@hotmail.com

Web: www.alimaniwinery.com

Nr. i punonjësve: 4

Përshkrim i shkurtër i kompanisë (Historiku)

Kantina Alimani u ndërtua në vitin 2016 nga dy djemtë e familjes Rezart dhe Erjon me mbështetjen e vazhdueshme të babait Ramazan. Ramazan dhe Rezart Alimani kthehen në Shqipëri pas një eksperience disa vjeçare vjeçare në Itali në një ndër kantinat më prestigjoze në Romë, Poggio Le Volpi. Ramazani nisi rrugëtimin e tij pranë kësaj kantine në vitin 2001 duke u marrë kryesisht me punë të ndryshme në vreshta, si krasitje, spërkatje, punim e vjelje. Pesë vite më vonë ju bashkua edhe Rezarti, menjëherë pasi kreu shkollën e mesme në Zerqan, Dibër, ku lidhja e ngushtë që kishte me të gjyshin Kasem Kaleci – Agronom, i ushqeu dashuri të madhe për natyrën, vreshtat dhe punën. Sapo shkoi në Romë në vitin 2006, Rezarti u përfshi menjëherë me punë dhe procese të brendshme në kantinë. Dashuria për punën dhe pasioni për verën përkthehen në këtë kantinë të re në emër por të pasur në eksperiencë. Që prej vitit 2016 vazhdojnë rrugëtimin tone plot passion dhe me objektiva ne permirsimin e vazhdueshem te produktit.

Shtetet ku eksporton



Zvicër



Poloni



Itali

Lista e produkteve që prodhojnë

Nr.	Produkti	Kapaciteti i prodhimit
1.	SHESH I ZI (<i>Variatet Autokton Shqiptar</i>)	6000 shishe
2.	SHESH I BARDHË (<i>Variatet Autokton Shqiptar</i>)	3000 shishe
3.	MERLOT	3000 shishe
4.	MERLOT REZERVE (<i>Stazhionuar 18 muaj barrik</i>)	3000 shishe



Emri i kompanisë: Kantina Arianiti

Data e themelimit: 16.02.2017

Nipti i kompanisë: L72616405A

Adresa e kompanisë: Rr. e "Gropallarëve", Patos, Fier

Personi i kontaktit: Bledar Gropa

Tel/ Cel: +355692030177

E-mail: info@arianitiwinery.al

Web: www.kantinaarianiti.al

Nr. i punonjësve: 4

Përshkrim i shkurtër i kompanisë (Historiku)

Kantina jonë fillimin e saj e ka që në periudhën e komunizmit në vitet 1985, ku babai jonë nisi të prodhonte verë dhe raki, me rrushin e kultivuar në atë pak tokë që na linte sistemi i atëhershëm, ku fillimisht prodhimi ishte për konsum të familjes dhe më pas për zonën përreth.

Në vitet e para të demokracisë në vitin 1993, ne filluam që ta zgjeronim aktivitetin duke shtuar sipërfaqet e mbjella me vresht dhe duke prodhuar në sasi më të madhe dhe të një cilësie më të mirë.

Me kalimin e viteve, pasioni ynë i dy vëllezërve Agronit dhe Bledarit dhe dëshira e babait që kishte për të prodhuar verëra të cilësisë së lartë, bëri që në vitin 2017 të themelojmë kantinën Arianit, duke investuar në ndërtimin e një kantine moderne me strukturë të re dhe me pajisje bashkëkohore.

Ne bashkëpunojmë me një grup Enologesh Italian dhe Shqipëtar të cilët kanë një kompani të quajtur Enologic Group me seli në Tiranë, të cilët ofrojnë asistencë teknike të specializuar për prodhimin e verës dhe të distilateve. Ato kanë edhe një laborator të akredituar për kontrollin fiziko-kimik, mikrobiologjik dhe organoshqisur të verërave dhe distilateve.

Shtetet ku eksporton



Angli




Shtetet e
Bashkuara të
Amerikës

Lista e produkteve që prodhojnë

Nr.	Produkti	Kapaciteti i prodhimit
1.	Verë të bardhë Dukasi (<i>Shesh i Bardhë/ shishe 0.75 l dhe 0.375 L</i>)	35.000 shishe
2.	Verë e kuqe Dukasi (<i>Merlot + kabernet Sauvignon/ për shishe 0.75 l dhe 0.375 L</i>)	55.000 shishe

Nr.	Produkti	Kapaciteti i prodhimit
3.	Verë e kuqe Shesh i Zi (100% shesh i zi/ për shishe 0.75 L)	40.000 shishe
4.	Verë e kuqe Nymphahion Superior (10 % Sheshi i zi, 55% Merlot dhe 35% Kabernet Sauvignon/ për shishe 0.75 l)	20.000 shishe
5.	Verë e bardhë (<u>formati Bag in box 5L</u>)	30.000 shishe
6.	Verë e kuqe (<u>formati Bag in box 5L</u>)	40.000 shishe
7.	Raki rrushi	10.000 shishe
8.	Raki rrushi e vjetërruar në barrik lisi	5.000 shishe





Emri i kompanisë: Xhelal Dervishi

Data e themelimit: 26.04.2007

Nipti i kompanisë: K71627505M

Adresa e kompanisë: Koxhas, Shijak

Personi i kontaktit: Xhelal Dervishi

Tel/ Cel: +355682277370

E-mail: xhelal.dervishi@yahoo.com

Nr. i punonjësve: 1

Përshkrim i shkurtër i kompanisë (Historiku)

Të vendosura në zemër të Shqipërisë së Mesme, vreshtat e kantinës "Dervishi" përfitojnë nga kombinimi i përsosur i klimës, tokës dhe pasionit. Cdo rrush zgjedhet me dashuri dhe kujdes për të siguruar cilësinë më të lartë të verës.

Lista e produkteve që prodhojnë

Nr.	Produkti	Kapaciteti i prodhimit
1.	Merlot -Kabernet	
2.	Shesh i zi/ Shesh i bardhë	400 HL
3.	Tokai "Babë e Bir"	

Llojet e certifikimeve që zotërojnë





Emri i kompanisë: Kantina Dogjani

Data e themelimit: 30.08.2017

Nipti i kompanisë: L78231202Q

Adresa e kompanisë: Kukës

Personi i kontaktit: Fatos Dogjani

Tel/ Cel: +355672284330

E-mail: dogjanishpk@hotmail.com

Nr. i punonjësve: 3

Përshkrim i shkurtër i kompanisë (Historiku)

Kantina Dogjani shpk u themelua me 30-08-2017 me iniciativën e z Fatos Dogjani me profesion teknolog i prodhimit të pijeve alkolike me një experiencë të gjatë në ushtrimin e këtij profesioni prej 30 viteve.

Kantina ka si objekt grumbullimin dhe përpunimin e të gjitha frutave të egra për prodhimin e rakive nga këto fruta si: manaferr e egër, thanë e egër, dardhë e egër, qershi e egër, ftua të egër, dëllinjë, kumbulla, rrush.

Gjithashtu kantina prodhon edhe pijen e veçantë GIN që përmban 16 lloje bimësh mjekësore të grumbulluara në zonë.

Të gjitha këto fruta që ne përpunojmë janë të rritura në zonën e Kukësit.

Lista e produkteve që prodhojnë

Nr.	Produkti	Formatet e ambalazhimit				Kapaciteti i prodhimit
1.	Raki Manaferre	0.7 L	0.2L	0.1L	0.05L	5.000 - 10.000 L
2.	Raki Thane	0.7 L	0.2L	0.1L	0.05L	5.000 - 10.000 L
3.	Raki Qershie e egër	0.7 L	0.2L	0.1L	0.05L	5.000 - 10.000 L
4.	Raki Ftoi	0.7 L	0.2L	0.1L	0.05L	5.000 - 10.000 L
5.	Raki Dardhe	0.7 L	0.2L	0.1L	0.05L	5.000 - 10.000 L
6.	Raki Dëllinje	0.7 L	0.2L	0.1L	0.05L	5.000 - 10.000 L

Nr.	Produkti	Formatet e ambalazhimit					Kapaciteti i prodhimit
		0.7 L	0.2L	0.1L	0.05L	0.5L	
7.	Raki Rrushhi	0.7 L	0.2L	0.1L	0.05L	0.5L	30.000 L
8.	Raki Kumbulle	0.7 L	0.2L	0.1L	0.05L	0.5L	20.000 L
9.	GIN	0.7L					20.000L
10.	Verë e kuqe Shesh i Zi	0.75L					10.000 L
11.	Verë e kuqe Vranac	5L	0.75L		187ML		20.000
12.	Verë e kuqe Merlot	0.75L					5.000 L
13.	Verë e kuqe Cabernet	0.75L					5.000 L
14.	Verë e bardhë Chardonnay	0.75L					5.000 L
15.	Verë e bardhë Riesling	5L	0.75L		187ML		20.000 L

Llojet e certifikimeve që zotërojnë





Emri i kompanisë: Kantina Flavio

Data e themelimit: 04.09.2015

Nipti i kompanisë: L52104549M

Adresa e kompanisë: Rr. Fushë - Koxhas, Durrës

Personi i kontaktit: Vath Dervishi

Tel/ Cel: +355682142192

E-mail: kantinaflavio@yahoo.com

Web: www.kantinaflavio.com.al

Nr. i punonjësve: 1

Përshkrim i shkurtër i kompanisë (Historiku)

Themeluar në vitin 2015, me kapacitet 130 HL në vit përdoren 3 metoda të fermentimit:

1. Fermentim i kuq;
2. Fermentim në të bardhë;
3. Fermentim malolaktik;

Administratori është me profesion enolog dhe specialist në cilësinë dhe sigurinë ushqimore. Kantina Flavio është një kantinë e vogël familjare e cila ka lulëzuar falë klimës mesdhetare dhe përkujdesjes tonë duke dhënë një lëndë të parë cilësore me anë të së cilës dhe produkti jonë final është i cilësisë së lartë.

Lista e produkteve që prodhojnë

Nr.	Produkti	Kapaciteti i prodhimit
1.	Verë e bardhë/ Chardonnay	30 HL
2.	Ros	10 HL
3.	Verë e kuqe/ MERLOT	80 HL
4.	Montepulciano Reserve	0 - 10 HL
5.	Kabernet Reserve	0 - 10 HL



Emri i kompanisë: KINOLLI DISTILLERY

Data e themelimit: 11.07.2018

Nipti i kompanisë: L84311001H

Adresa e kompanisë: KM 10, Korçë – Tiranë

Personi i kontaktit: Andon Kinolli

Tel/ Cel: +355695250053

E-mail: kantinakinolli@gmail.com

Web: www.kinolli-distillery.com

Nr. i punonjësve: 4

Përshkrim i shkurtër i kompanisë (Historiku)

"I distiluar në Shqipëri, i shijuar nëpër botë!", me këtë citim që na ka ndjekur prej dekadash, zoti Kinolli ka lënë pas një thesar në trashëgiminë e prodhimit të Rakisë. Në Kinolli Distillery do të keni mundësinë të provoni dhe shijoni varietetet e Rakisë të prodhuara. Vreshta është në vetvete një vepër arti, e krijuar nga dashuria dhe vizioni i madh që zoti Kinolli kishte për atë që sot është një nga distileritë kryesore në Shqipëri.

Arti i krijimit të spirits kërkon një përzjerje unike të krijimtarisë, shkencës dhe durimit. Nga marrja e përbërësve me cilësi të lartë deri te matjet e sakta dhe koha e procesit të distilimit, çdo hap duhet të konsiderohet me kujdes për të prodhuar profilin e shijes së dëshiruar. Në Kinolli Distillery, ne jemi të apasionuar pas krijimit të pijeve alkoolike me cilësi të lartë, të punuar me dorë, që pasqyrojnë traditat dhe vlerat e komunitetit tonë. Ne marrim vetëm përbërësit më të mirë dhe përdorim metoda tradicionale për të prodhuar një sërë pijesh alkoolike që janë vërtet unike dhe autentike.

Shtetet ku eksporton



Kenya

Lista e produkteve që prodhojnë

Nr.	Produkti	Kapaciteti i prodhimit
1.	Raki Rrushi	16.000 L
2.	Raki e Vjetëruar	3000 L

Llojet e certifikimeve që zotërojnë





Kantina Sulova

Emri i kompanisë: Kantina SULOVA FH SHPK

Data e themelimit: 09.2017

Nipti i kompanisë: M32723202A

Adresa e kompanisë: Rr. Ura Sulovës, Cërrrik

Personi i kontaktit: Alban Hoxha

Tel/ Cel: +355676050322

E-mail: kantina.sulova2018@gmail.com

Web: www.kantinasulova.com

Përshkrim i shkurtër i kompanisë (Historiku)

Kantina Sulova është themeluar në vitin 2007 me një kapacitet të vogël prodhimi në vreshtat e familjes Hoxha.

Çdo vit ka sjellë rritje të cilësisë dhe prodhimit dhe në vitin 2018 nisi eksporti me tregun e huaj.

Në vitin 2023, Sulova nr. 2 hap dyert, duke krijuar një mjedis ku mund të shijoni verërat tona në të njëjtën kohë teksa rrushi përpunohet.

Shtetet ku eksporton



Zvicër

Lista e produkteve që prodhojnë

Nr.	Produkti	Kapaciteti i prodhimit
1.	Kallmet	8.000 shishe
2.	Shesh i bardhë	11.000 shishe
3.	Merlot	13.000 shishe



Emri i kompanisë: Bakus SHPK

Data e themelimit: 12.01.2022

Nipti i kompanisë: M21312510H

Adresa e kompanisë: Fshati Rade, Manez, Durrës

Personi i kontaktit: Laert Gjergji

Tel/ Cel: +355684003336

E-mail: radawinery@hotmail.com

Nr. i punonjësve: 2

Përshkrim i shkurtër i kompanisë (Historiku)

Verërat e Kantinës Rada janë të prodhuara në kodrat e Radës, nga 150-200 metra mbi nivelin e detit.

Të mbjella në vitet 1975 vreshtat e tyre zënë një sipërfaqe të vogël prej 2 ha me varietetin autokton Shesh i bardhë dhe varietetin Merlot.

Vjetërsia e vreshtave jep prodhim të pakët në sasi por tepër cilësor.

Rada favorizohet nga influenca e mrekullueshme e detit Adriatik.

Lista e produkteve që prodhojnë

Nr.	Produkti	Kapaciteti i prodhimit
1.	Merlot (750 ml qelqi)	6.000 shishe
2.	Shesh i bardhë (750 ml qelqi)	5.000 shishe



Emri i kompanisë: Venari HERTA

Data e themelimit: 01.09.2000

Nipti i kompanisë: K82025501B

Adresa e kompanisë: Maminas

Personi i kontaktit: Rozan Osmani

Tel/ Cel: +355686797703

E-mail: kantinaherta@gmail.com

Web: www.kantinaherta.al

Nr. i punonjësve: 10

Përshkrim i shkurtër i kompanisë (Historiku)

Kantina Herta nuk është tjetër veçse Kantina e familjes Hamdi Osmani. Krijuar nga kjo familje, ajo nisi prodhimin pasi kishite krijuar një sipërfaqe prej 4,5 hektarësh vresht në Maminas e rrethina, sipërfaqe të cilën e ka çuar deri në 6 hektarë. Teknologjia e saj italiane "Della Tofolla" i jep mundësinë asaj të prodhojë verëra të cilësisë së lartë dhe të jetë një konkuresse e denjë në tregun e verërave shqiptare. Me llojet e kultivarëve si Merlot, Trebiano, Toscano, Kabërnët, etj., Herta ka krijuar produkte mjaft interesante si Bukuroshja e Maminasit, Merlot Dyrrah, Kabërnët Savinjon, Merlot Trebiano etj.

Shtetet ku eksporton



Mali i Zi



Hollandë

Lista e produkteve që prodhojnë

Nr.	Produkti	Kapaciteti i prodhimit
1.	Shesh i zi	80.000 - 100.000 litra/ vit
2.	Shesh i bardhë	4000 - 5000 litra/ vit
3.	Trebiano	4000 - 5000 litra/ vit

Llojet e certifikimeve që zotërojnë





Emri i kompanisë: VERA LIBRAZHD shpk

Data e themelimit: 1993

Nipti i kompanisë: J67902609N

Adresa e kompanisë: Rr. Qazim Murtini, Librazhd

Personi i kontaktit: Rahman Gjeta; Enis Gjeta

Tel/ Cel: +355692090486; +355693257155

E-mail: veralibrazhd@gmail.com

Nr. i punonjësve: 15

Përshkrim i shkurtër i kompanisë (Historiku)

Kantina e Verës Librazhd është themeluar në vitin 1960. Kapaciteti i përpunimit të rrushit ishte 1000 ton rrush në sezon. Teknologjia e përdorur në atë kohë është huazuar nga ish B.S (Rusia). Rrushi si lëndë e parë për prodhimin sigurohej nga rrethi i Librazhdit dhe pjesërisht nga rrethi i Elbasanit.

Para viteve 1990 zona e Librazhdit ka patur rreth 390 ha vreshta nga të cilat 203 ha për prodhim të varietetve Shesh i Bardhë, Shesh i Zi, Reosling, Kabernet Souvinjon, Tokai etj.

Kantina e Verës Librazhd prodhonte alkool rrushi, raki rrushi dhe verëra të kuqe dhe të bardha sipas varietetit të rrushit.

Nga kjo kantinë në vitet 1962-1964 është eksportuar për herë të parë 40 hl verë Kabernet në Angli.

Më pas nëpërmjet Kantinës së Verës Durrës janë eksportuar rreth 3000 hl verë Reisling kryesisht në Poloni, Hungari, Serbi dhe Rumani.

Në vitin 1992 Kantina e Verës Librazhd privatizohet dhe merr emrin VERA LIBRAZHD shpk, emër të cilin mban edhe sot.

Kantina e Verës Librazhd mund të konsiderohet një nga kantinat më të vjetra dhe më të mëdha në Shqipëri.

Nga viti 1960 Kantina e verës Librazhd ka fitur mbi 30 çmime në konkurset kombëtare të organizuara në Shqipëri.

Lista e produkteve që prodhojnë

Nr.	Produkti	Kapaciteti i prodhimit
1.	Kabernet	100 HL
2.	Tokai	200 HL
3.	Shesh i zi (0.75l)	100 HL
4.	Shesh i bardhë	100 HL

Nr.	Produkti	Kapaciteti i prodhimit
5.	Raki Moskat	50 HL
6.	Raki Shafran	20 HL
7.	Konjak	10 HL
8.	Fernet	5 HL
9.	Liker të ndryshëm	5 HL

Llojet e certifikimeve që zotërojnë





Emri i kompanisë: Enofama

Data e themelimit: 2004

Nipti i kompanisë: K94016402J

Adresa e kompanisë: Toshkez, Lushnje

Personi i kontaktit: Enrik Malia

Tel/ Cel: +355 684061616

E-mail: info@enofarma.com

Web: www.enofarma.com

Nr. i punonjësve: 12

Përshkrim i shkurtër i kompanisë (Historiku)

Puna jonë nisi në vitin 1998 me mbjelljen e 3 dynym vresht, pas një pasioni që nisi në emigrim. Sot kemi në pronësi 35 hektarë vresht, siperfaqe të cilat janë shtuar nga pak vit pas viti me plot përkushtim, sfida dhe dashuri për këtë sektor. Aktualisht prodhojmë tetë lloj të ndryshme verërash dhe raki me një volum prej 300 mijë litra.

Shtetet ku eksporton



Greqi



Suedi

Lista e produkteve që prodhojnë


Nr.	Produkti	Kapaciteti i prodhimit
1.	Toska e bardhë	8.000 shishe
2.	Rozali	10.000 shishe
3.	Toska e kuqe	10.000 shishe
4.	Shesh i bardhë	10.000 shishe

Nr.	Produkti	Kapaciteti i prodhimit
5.	Vranats	10.000 shishe
6.	Verë e bardhë Trebiano	150.000 L
7.	Verë e kuqe Merlot	80.000 L
8.	Raki rrush	3.000 shishe

Llojet e çertifikimeve që zotërojnë



CACO



KANTINA

Emri i kompanisë: Kantina CACO

Data e themelimit: 30.01.2008

Nipti i kompanisë: K83730602R

Adresa e kompanisë: Grabovicë, Pogradec

Personi i kontaktit: Ersol Caco

Tel/ Cel: +355 692052801

E-mail: kantinacaco@gmail.com

Web: www.kantinacaco.com

Nr. i punonjësve: 5

Përshkrim i shkurtër i kompanisë (Historiku)

Kantina Caco ka nisur aktivitetin në vitin 1993 me prodhimin e rakisë, rreth vitit 2000 vreshtat dhe prodhimi i rakisë dhe verës ka qenë aktiviteti i vetëm i familjes, në vitin 2012 certifikohet me ISO 22000 për sigurinë ushqimore, në vitin 2018 në bashkëpunim me AZHBR investohet në gjithë linjën e prodhimit të re duke rritur standartin e prodhimit kapacitetin dhe cilësinë. Aktualisht kantina Caco ka 6 etiketa vere dhe 2 etiketa raki dhe brenda vitit 2024 fillon eksportin me Zvicrën dhe Anglinë.

Shtetet ku eksporton



Gjermani



Mali i Zi



Belgjikë



Itali

Lista e produkteve që prodhojnë

Nr.	Produkti	Kapaciteti i prodhimit
1.	Lyhni i bardhe	15.000 shishe
2.	Muskat	6.000 shishe
3.	Pamid	3.000 shishe

Nr.	Produkti	Kapaciteti i prodhimit
4.	Lyhni I Kuq	8.000 shishe
5.	Harmoni	10.000 shishe
6.	Sekret	3.000 shishe

Llojet e certifikimeve që zotërojnë





Emri i kompanisë: Duka Wine

Data e themelimit: 18.06.2020

Nipti i kompanisë: M01818504G

Adresa e kompanisë: Lalëz, Ishëm, Durrës

Personi i kontaktit: Evalt Domi

Tel/ Cel: +355 686013005

E-mail: evaltdomi@hotmail.com

Web: www.kantinaduka.al

Nr. i punonjësve: 33

Përshkrim i shkurtër i kompanisë (Historiku)

Aktiviteti i kompanisë ka nisur në vitin 2004 me mbjedhjen e sipërfaqjes prej 5,5 hektar të vreshtave për prodhimin e verës. Në vitin 2007 kantina ka prodhuar verën e parë dhe fokusi kryesor i kantinës është rritja e cilësë të verës nëpërmjet aplikimit të teknologjisë të fundit dhe rritjes të investimeve periodike në sektor. Kantina në vitin 2019 zgjeron aktivitetin e saj me hapjen e restorantit dhe në vitin 2025 do të zgjerohet në shërbimin e hotelerisë. Kantina është vlerësuar me çmime të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare për cilësinë e verës.

Shtetet ku eksporton



Angli



Belgjikë



Itali

Lista e produkteve që prodhojnë

Nr.	Produkti	Kapaciteti i prodhimit
1.	Shesh i bardhë	14.000 shishe
2.	Merlot	14.000 shishe
3.	Tempranillo	15.000 shishe

Nr.	Produkti	Kapaciteti i prodhimit
4.	Cabernet Sauvignon	7.000 shishe
5.	Reserva	7.000 shishe
6.	Reserva Superiore	5.000 shishe

Llojet e certifikimeve që zotërojnë





Emri i kompanisë: Vreshti i Pashait

Data e themelimit: 18.09.2015

Nipti i kompanisë: L58318001B

Adresa e kompanisë: Leskovik; Përmet

Personi i kontaktit: Albert Gajo

Tel/ Cel: +355672022773

E-mail: albertgajo@hotmail.com
majlinda.guri@gmail.com

Nr. i punonjësve: 5

Përshkrim i shkurtër i kompanisë (Historiku)

Kantina Dogjani shpk u themelua me 30-08-2017 me iniciativën e z Fatos Dogjani me profesion teknolog i prodhimit të pijeve alkoolike me një experiencë të gjatë në ushtrimin e këtij profesioni prej 30 viteve.

Kantina ka si objekt grumbullimin dhe përpunimin e të gjitha frutave të egra për prodhimin e rakive nga këto fruta si: manaferr e egër, thanë e egër, dardhë e egër, qershii e egër, ftua të egër, dëllinjë, kumbulla, rrush.

Gjithashtu kantina prodhon edhe pijen e veçantë GIN që përmban 16 lloje bimësh mjekësore të grumbulluara në zonë.

Të gjitha këto fruta që ne përpunojmë janë të rritura në zonën e Kukësit.

Lista e produkteve që prodhojnë

Nr.	Produkti	Kapaciteti i prodhimit
1.	Shiraz 2021 Reseve	5.000 shishe
2.	Cabernet Sauvignon 2021	2.000 shishe
3.	Debina 2023	1.000 shishe
4.	Merlot 2020 Reseve	700 shishe
5.	Rose 2022	800 shishe
6.	Chardonnay 2021	1.200 shishe

Nr.	Produkti	Kapaciteti i prodhimit
7.	Shesh I Zi & Mavrud 2022	1.200 shishe
8.	Mavrud 2021	700 shishe
3.	Raki	300 shishe



KANTINA ARBËRI
"TURKO-GDSH" SH.PK

Emri i kompanisë: KANTINA ARBËRI

Data e themelimit: 17.01.2005

Nipti i kompanisë: J69102005R

Adresa e kompanisë: KM 1, Rr. Rrëshen-Kurbnesh

Personi i kontaktit: Rigers Kaçorri

Tel/ Cel: +355694433773

E-mail: rigerskacorri@gmail.com

Web: www.kantina-arberi.com

Nr. i punonjësve: 19

Përshkrim i shkurtër i kompanisë (Historiku)

Kantina e verës "ARBËRI" fillon aktivitetin e saj në vitin 2003. E veçanta e prodhimit është varieteti i rrushit autokton shqiptar Kallmet. Ky rrush prodhohet në një zonë shumë të njohur për vreshtat dhe traditën e verës shqiptare.

Ë prodhuar në kodrat e larta të Bukmirës, nga 400-550m mbi nivelin e detit, njihen si vreshtat më të mira në të gjithë krahinën dhe përtej trojeve të saj.

Vreshtaria e Bukmirës të dhuron një buçetë me aroma të këndshme dhe të ëmbëla të verës.

Gama e aktivitetit ekonomik ka ardhur gjithnjë në rritje, duke filluar në vitet e para me aktivitet tregëtar brenda vendit, dhe më pas duke u zgjeruar në aktivitete import-eksporti, ndërtim, mirëmbajtje mjedisi dhe turizëm.

Duke u nisur nga tradita e herëshme e trevës së Mirditës për kultivimin e vreshtit dhe prodhimit e verës, dhe me dëshirën e mirë për të ringjallur këtë traditë, Administratori i kësaj Kompanie, z. Fran Kaçorri, vendosi të investojë për ngritjen e një kantine vere e cila do të ishte përfaqësuese e kësaj tradite në prodhimet autokotone të zonës. (Duke prezantuar një Brand, i cili do të përfaqësonte prodhimet autokotone të zonës në fushën e verëtarisë).

Lista e produkteve që prodhojnë

Nr.	Produkti	Kapaciteti i prodhimit
1.	Verë Kallmet Rezervë	55.000 shishe
2.	Verë Kallmet Klasik	35.000 shishe
3.	Verë Shesh i Bardhë	35.000 shishe
4.	Verë e gazuar Ardo	3.000 shishe
5.	Raki e Vjetëruar	6.000 shishe
6.	Raki Tradicionale	6.000 shishe

Llojet e certifikimeve që zotërojnë



Shtetet ku eksporton



Angli

Zvicër

Kosovë

Francë

Gjermani

Serbi



Emri i kompanisë: Kantina UKA

Data e themelimit: 2010

Nipti i kompanisë: L11306008C

Adresa e kompanisë: Rr. Adem Jashari, Laknas, Tiranë

Personi i kontaktit: Flori Uka

Tel/ Cel: +355695222220

E-mail: info@ukawine.com

Web: www.ukawine.com

Nr. i punonjësve: 18

Përshkrim i shkurtër i kompanisë (Historiku)

Kantina Uka është themeluar në vitin 2005. Objektivi i kantinës Uka është të punojë me kultivarët vendas si dhe të krijojë një mbledhje të dhënash (*datbazë*), e cila do të shërbejë Shqipërisë për të shkruar historinë e lashtë të prodhimit të verës që daton 4000 vjet më parë. Kantina jonë bashkëpunon me përreth 250 familje në gjithë Shqipërinë, ku mbledhim rrushet autoktone në zonat e tyre dhe i përpujnjmë në kantinë duke prodhuar vera të një cilësie të lartë.

Kantina Uka ka si objektivi të promovojë vlerat e vreshtarisë dhe vertarisë shqiptare, duke shërbyer edhe si një muze, ku turistët të provojnë Shqipërinë në shishe. Gjithashtu synojmë të fusim Shqipërinë në hartën e verave botërore.

Shtetet ku eksporton



Itali



Shtetet e
Bashkuara të
Amerikës

Lista e produkteve që prodhojnë

Nr.	Produkti	Kapaciteti i prodhimit
1.	Kallmet	12.000 shishe/ vit
2.	Ceruja	6.000 shishe/ vit
3.	Pulëz	6.000 shishe/ vit



Emri i kompanisë: Kantina PERLA

Data e themelimit: 29.08.2018

Nipti i kompanisë: L87029203H

Adresa e kompanisë: Rr. Brakajve, Novosele, Vlorë

Personi i kontaktit: Marsel Beqiraj

Tel/ Cel: +355695874667

Nr. i punonjësve: 2

Përshkrim i shkurtër i kompanisë (Historiku)

Kantina Perla ndodhet në Cerkovinë të Vlorës, prej gjashtë vitesh operon në treg. Është një kantinë e investuar me të gjithë pajisjet dhe teknologjinë bashkekohore.

Zoteron në pronësinë e saj katër hektarë vreshta në kodrat e bukura të zonës. Me tregun operon në restorante, markete dhe klientë të drejtpërdrejt familjar, në Vlorë dhe qytete të tjera të Shqipërisë.

Kemi krijuar infrastrukturën e duhur nga ana e dokumentacionit dhe jemi në hapat e fundit për fillimin e eksportit drejt SHBA.

Lista e produkteve që prodhojnë

Nr.	Produkti	Kapaciteti i prodhimit
1.	Verë e kuqe	50.000 shishe
2.	Verë e bardhë	20.000 shishe
3.	Rose	10.000 shishe



Emri i kompanisë: Kantina Nurellari

Data e themelimit: 1996

Nipti i kompanisë: K63413003I

Adresa e kompanisë: Berat

Personi i kontaktit: Levent Nurellari

Tel/ Cel: +355697694770

E-mail: leventnurellari@yahoo.com

Web: www.nurellariwinery.com

Nr. i punonjësve: 10

Përshkrim i shkurtër i kompanisë (Historiku)

Kantina Nurellari është themeluar në vitin 1995 nga familja NURELLARI. Nga viti i krijimit e deri më sot, cilësia e prodhimit dhe e produkteve janë rritur. Vëndndodhja e kantinës është midis qytetit të Beratit dhe Poliçanit, në një distancë prej 10 km nga Berati. Ne besojmë se rruga drejt suksesit është në duart tona.

Ne gjithashtu besojmë se çelësi i suksesit është të ofrojmë cilësinë më të lartë duke garantuar çmime të arsyeshme. Vera jonë konsiderohet si një nga produktet më të mira në Shqipëri por jo vetëm. Në vitin 2016, Kantina Nurellari në konkursin ballkanik (*Balkan International Competition 2016 Sofia, Bullgari*) u nderua me medalje argjendi për verën Pulsi Beratit 2015. Gjithashtu, më 17 dhjetor 2015 dhe 16 dhjetor 2016, Kantina Nurellari u shpërblye në shkallë kombëtare, konkursi i organizuar nga Ministria e Bujqësisë duke fituar çmime për kategorinë e verërave të kuqe të vjetruara përkatësisht në vitin 2015 me çmimin e parë Reserva 2012 dhe Montemeca 2009, gjithashtu në vitin 2016 me verën Reserva Superiore 2013 vera më e mirë shqiptare.

Shtetet ku eksporton



Zvicër



Hollandë



Belgjikë



Gjermani

Lista e produkteve që prodhojnë

Nr.	Produkti	Kapaciteti i prodhimit
1.	Pulsi i Beratit	15.000
2.	Montemeca	24.000
3.	Riserva Superiore	3.500

Llojet e çertifikimeve që zotërojnë



SEKTORI I VAJIT TË ULLIRIT





Emri i kompanisë: BIOLIVE

Data e themelimit: 10.01.2023

Nipti i kompanisë: M33725401P

Adresa e kompanisë: Rr. Cerme e Sipërme, Divjakë

Personi i kontaktit: Arber Satka

Tel/ Cel: +355689022999

E-mail: arber@bioliveoil.com

Web: www.bioliveoil.com

Nr. i punonjësve: 1

Përshkrim i shkurtër i kompanisë (Historiku)

Në BIOLIVE, pasioni ynë i palëkundur për produktet më të mira të natyrës na motivon të prodhojmë vaj ulliri autentik të cilësisë së lartë.

Të vjelur me dorë nga ullinjtë shekullor të zonave kodrinore të Beratit, Fierit, Vlorës, Elbasanit dhe Peqinit ullinjtë tanë janë të shtypur në të ftohtë për të ruajtur shijen dhe freskinë e tyre natyrale.

Ne besojmë se dashuria, pasioni dhe përkushtimi me të cilin mbushim çdo shishe, është i dukshëm në çdo pikë vaji.

Në BIOLIVE ne nuk prodhojmë thjesht vaj ulliri, ne përcjellim një trashëgimi të esencës së natyrës dhe traditës, nga ullinjtë shekullorë të Shqipërisë në tavolinën tuaj.

Shtetet ku eksporton



Zvicër



Itali

Lista e produkteve që prodhojmë

Nr.	Produkti	Kapaciteti i prodhimit
1.	Vaj Ulliri Ekstra i Virgjër	130.000 litra
2.	Vaj Ulliri i Virgjër	70.000 litra



SHKALLA SH.

Emri i kompanisë: SHKALLA

Data e themelimit: 1996

Nipti i kompanisë: J61923015W

Adresa e kompanisë: Lundër, Tirana

Personi i kontaktit: Shpresa Shkalla

Tel/ Cel: +355672068924

E-mail: info@shpresashkalla.com

Web: www.shpresashkalla.com

Nr. i punonjësve: 6

Përshkrim i shkurtër i kompanisë (Historiku)

Themeluar në vitin 1996 nga Shpresa Shkalla e cila vjen nga një familje që e ka traditë përpunimin e vajit të ullirit.

Kompania është certifikuar në vitin 2002 nga BioInspecta si një produkt organik.

Eksportimi i parë është bërë në vitin 2005 në Zvicër.

Duke filluar nga viti 2005 merr pjesë në konkursin Nderkombetar BIOL nga i cili çdo vit vlerësohet me çmime të tilla si:

BIOL ALBANIA
GOLD MEDAL
EXTRA GOLD MEDA

Shtetet ku eksporton



Zvicër



Gjermani

Lista e produkteve që prodhojnë

Nr.	Produkti	Kapaciteti i prodhimit
1.	Vaj Ulliri Ekstra i Virgjër	20 Ton

Llojet e certifikimeve që zotërojnë





Emri i kompanisë: FEDERATA BUJQESORE ELBASAN

Data e themelimit: 12.03.2007

Nipti i kompanisë: K73117205C

Adresa e kompanisë: Shirgjan, Elbasan

Personi i kontaktit: Agron Cakalli

Tel/ Cel: +355686026342

E-mail: agron_cakalli@yahoo.com

Nr. i punonjësve: 3 – të përhershëm (full time)
10 – sezonal (part time)

Përshkrim i shkurtër i kompanisë (Historiku)

FBE e krijuar nga katër OJF në një projekt të kooperacionit Italian për zhvillimin e bujqësisë ka 125 anëtarë.

Aktiviteti i FBE është përpunimi i ullirit, grumbullimi, ambalazhimi, tregëtimi i vajit të ullirit ekstra të virgjër brenda dhe jashtë vendit.

FBE është regjistruar me markën e saj VALMI dhe është në treg nga viti 2008.

Shtetet ku eksporton



Maqedonia
e Veriut



Greqi



Zvicër



Kosovë



Maltë



Shtetet e
Bashkuara të
Amerikës

Lista e produkteve që prodhojnë

Nr.	Produkti	Kapaciteti i prodhimit
1.	Vaj Ulliri Ekstra i Virgjër	20 KW/orë

Llojet e çertifikimeve që zotërojnë





Emri i kompanisë: Bregu Lofatave shpk

Data e themelimit: 12.08.2021

Nipti i kompanisë: M17016201M

Adresa e kompanisë: Rr. Ismail Qemali, Vlorë

Personi i kontaktit: Florian Shtytaj

Tel/ Cel: +355 675114322

E-mail: uliveto.lufata@gmail.com

Web: www.bregulofatave.com

Nr. i punonjësve: 1

Përshkrim i shkurtër i kompanisë (Historiku)

Bregu Lofatave, është rrjedhojë logjike e formalizimit korrekt e serioz i një aktiviteti të nisur vite më parë (2009) në fushën e agrikulturës. Një ullishte e ndërtuar nga zero në një hapsirë të blerë, rreth 12 hektarë, në kodrat e bukura të Risilisë në Vlorë. U krijua duke ndjekur mënyrat më të mira shkencore të lidhura me ullishtarinë dhe duke qenë të prirur për të aplikuar vazhdimisht inovacione të ndryshme në punën tonë, ujitje digjitale, trajtime inovatore në respekt të ambientit etj.

Kemi bashkëpunim të ngushtë me Institutin e Ullirit Vlorë. Me synim të qartë për prodhimin e vajit ekstra të virgjër cilësor, të standarteve të BE, na tregoi rrugën e krijimit të kompanisë në 2021. Kjo na mundësoi më pas krijimin dhe ruajtjen e logos dhe etiketës, si dhe mundësinë e eksportit. I japim një rëndësi të veçantë standartizimit të prodhimit dhe ambalazhimit. Tregëtojmë ekskluzivisht dhe vetëm në kontenitore të certifikuar, të etiketatura e kuruar në detaje, me material shumë cilësor, të prodhuara në Itali. Synojmë të forcojmë shitjet në dyqane tipike dhe markete cilësore në Shqipëri, dhe të gjejmë hapsira në tregjet e BE, SHBA, Japoni, Lindjen e Mesme.

Shtetet ku eksporton



Zvicër

Lista e produkteve që prodhojnë

Nr.	Produkti	Kapaciteti i prodhimit
1.	Vaj Ulliri Ekstra i Virgjër	6-8 mijë litra (momentalisht)

Llojet e certifikimeve që zotërojnë





Emri i kompanisë: Mallakastra Vaj Ulliri

Data e themelimit: 17.11.2003

Nipti i kompanisë: K37510867I

Adresa e kompanisë: KM 2, Rr. Ballsh-Aranitas

Personi i kontaktit: Viktor Pajaj

Tel/ Cel: +355 694045906

E-mail: viktorpajaj@yahoo.com

Nr. i punonjësve: 4 (*sezonal*)

Përshkrim i shkurtër i kompanisë (Historiku)

Kompania jonë është themeluar në vitin 2003. Fusha ku ne operojme është përpunimi i ullirit. Në vitet e para kemi pasur makineri të vjetra, ndërsa kohët e fundit kemi investuar në teknologjinë bashkëkohore 'Pieralisi'. Gjithashtu, kemi filluar tregëtimin e vajit të ullirit me logon tonë 'Mallakastra Vaj Ulliri'.

Lista e produkteve që prodhojnë

Nr.	Produkti	Kapaciteti i prodhimit
1.	Vaj Ulliri	2,5 ton/ orë



Emri i kompanisë: Vaj Ulliri BELSHI

Data e themelimit: 10.2016

Adresa e kompanisë: Belsh, Elbasan

Personi i kontaktit: Loren Senja

Tel/ Cel: +355 673927794

E-mail: vajulliribelshi@gmail.com

Nr. i punonjësve: 3

Përshkrim i shkurtër i kompanisë (Historiku)

Ne jemi një familje fermere nga Belshi dhe kujdesemi për ullinjtë tanë gjatë gjithë vitit. Pas vjeljes, i dërgojmë ullinjtë në fabrikë dhe vajin e prodhuar, një pjesë e mbajmë vetë dhe pjesën tjetër e shesim për të mbuluar shpenzimet dhe siguruar disa të ardhura për prindërit që angazhohen me to. Ne e vjelim ullirin, e dërgojmë në fabrikë dhe vajin e prodhuar, një pjesë e mbajmë për vete dhe një pjesë e shpërndajmë me makinën tonë tek klientët sipas qyteteve.

Ne prodhojmë vajin ekstra te virgjër, i cili konsiderohet si një ndër më cilësorët në treg. Duke qenë se sasia e prodhuar nuk është e madhe dhe ullirin e dërgojmë njëherësh në fabrikë, mbajmë vetëm këtë cilesi dhe jo të tjera si 'virgine', etj.

Sasia e prodhuar nuk është e madhe dhe është kryesisht e shitur prej porosive të klientëve të vjetër që marrin tek ne prej disa vitesh. Jemi duke zgjeruar ullishten, rrëshimisht edhe prodhimin në vitet në vijim, kështu na duhen blerës edhe për vitet e tjera dhe jo vetëm për këtë vit. Shumicën e vajit e shesim tek klientet e vjetër, besnikëria e tyre tregon ruajtjen e standardit prej nesh.

Lista e produkteve që prodhojnë

Nr.	Produkti	Kapaciteti i prodhimit
1.	Vaj Ulliri	20.000 KG



Emri i kompanisë: Fabrikë vaj ulliri 'Nazeraj'

Data e themelimit: 16.08.2005

Nipti i kompanisë: L53407414R

Adresa e kompanisë: Peshtan, Fier

Personi i kontaktit: Ylli Nazeraaj

Tel/ Cel: +355 698444411

E-mail: yllifabrika@gmail.com

Nr. i punonjësve: 4 (*sezonal*)

Përshkrim i shkurtër i kompanisë (Historiku)

Fabrika e vajit të ullirit 'Nazeraj' është themeluar në vitin 2005 me eksperiencë prej 18 vitesh në treg duke e bërë kështu prodhimin e vajit cilësor objektivin tonë primar. Ky proces kryhet nën kujdesin dhe mbikëqyrjen e plotë të punëtorëve, në mënyrë që vaji të prodhohet në temperaturën e duhur dhe për të bërë pastrimin sa më të kujdesshëm nga gjethet apo papastërtitë e tjera.

Qëllimi ynë është plotësimi i kërkesave të klientëve në bazë të llojeve të ndryshme të ullirit, si: kalinjot, korronek, franktoi.

Ne gjithashtu ofrojmë dhe transportin për të gjithë klientët tanë me përjashtim të rasteve kur ata duan të shikojnë procesin e prodhimit të vajit.

Lista e produkteve që prodhojnë

Nr.	Produkti	Kapaciteti i prodhimit
1.	Ullinj kalinjot	3.000 – 5.000 KV
2.	Ullinj korronek	2.000 – 3.000 KV
3.	Ullinj nisjot	2.000 – 3.000 KV

Shtetet ku eksporton



Greqi



Itali



Belgjikë



Emri i kompanisë: Subashi Olive Oil

Data e themelimit: 2018

Nipti i kompanisë: L82326012B

Adresa e kompanisë: Tiranë

Personi i kontaktit: Silvana Subashi

Tel/ Cel: +355 684094211

E-mail: silvana_pinari@yahoo.com

Nr. i punonjësve: 4

Përshkrim i shkurtër i kompanisë (Historiku)

Kompania është themeluar si rezultat i nxjerrjes në tregun e suvenireve produkte të tilla si vaj i ullirit, punimet në dru ulliri për kuzhinë, dekor kuzhine, vepra arti të punuara në dru ulliri, kompozime të ndryshme dhuratash të personalizuar.

Vaji i ullirit Subashi është një nga kompanitë më të mëdha në vend për përpunimin e vajit të ullirit. Ne jemi një prodhues të vajit të ullirit ekstra të virgjër..

Ullinjtë tanë ndodhen në Marikaj të Tiranës, në një zonë të njohur që nga kohërat e lashta për rritjen e ullinjve disa qindra vjeçarë. Varieteti kryesor është Ulliri Kalvinist, një vaj ulliri me vlera të mëdha ushqyese dhe antikancerogjene.

Vaji i ullirit “Subashi” prodhon gjithashtu vaj ulliri pikant të kombinuar me bimë mjekësore dhe aromatike, si dhe produkte kozmetike me bazë ulliri.

Vaji i ullirit Subashi është nderuar me “Vulnerabilitetin e Cilësisë” 2014 nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Menaxhimit të Ujërave. Gjithashtu jemi vlerësuar me një sërë çmimesh në panairet dhe konkurset kombëtare të vajit të ullirit në vend.

Lista e produkteve që prodhojnë

Nr.	Produkti	Kapaciteti i prodhimit
1.	Vaj ulliri Ekstra i virgjër	20.000 L
2.	Punime ene kuzhine	50 m3 dru ulliri në vit
3.	Punime artistike në dru ulliri	20 m3 dru ulliri në vit

Llojet e çertifikimeve që zotërojnë





Emri i kompanisë: Musai Olive Oil

Data e themelimit: 1995

Nipti i kompanisë: LO7127201A

Adresa e kompanisë: Skroftinë, Vlorë

Personi i kontaktit: Kejda Musa

Tel/ Cel: +355 692619605

E-mail: info@musaioliveoil.com

Web: www.musaioliveoil.com

Nr. i punonjësve: 8

Përshkrim i shkurtër i kompanisë (Historiku)

Vaji i ullirit Musai është një nga markat lider të prodhimeve shqiptare e cila daton që nga viti 1995 dhe është e pozicionuar në Vlorë perballë kodrave të ullinjve shekullore.

Vaji i ullirit Musai konkuron denjësisht në tregun vendas dhe të huaj si produkt i certifikuar bio/organik në New York, Hong Kong, Tokyo etj.

Fabrika prodhon vaj vetëm nga ullinj të zonës së Vlorës, të rritur dhe kultivuar në mënyrë organike dhe një nga rajonet më të pasur në vend me ullinj dhe i famshëm për praninë dhe kultivimin e varietetit autokton "KALINJOT", unik për cilësitë e pakrahasueshme e të pakonkurrueshme të vajit. Vlerësuar me 16 Medalje Ari në konkurse Nderkombëtare.

Pjesëmarrja në panaire ndërkombëtare si Fancy Food Show në New York e Washington, Foodex në Japoni, Biofach në Gjermani, CEEC Expo në Kinë dhe shumë të tjera kanë qenë forma kryesore e promovimit të vajit të ullirit cilësor Shqipëtar në tregjet ndërkombëtare.

Shtetet ku eksporton



